



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/67

Datë: 30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 61 dhe 62 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/67

Datë: 30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani Vjetor i Punës së Qeverisë për vitin 2016.
2. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin Legjislativ për vitin 2016 t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/67

Datë: 30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe Provimeve Profesionale në Institucionet Publike.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/67

Datë: 30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Përcjelljen e Emisioneve të Gazrave Serë.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/67

Datë: 30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 13 të Ligjit nr. 05/L-001 ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-046 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Financave për kursime dhe ndarje buxhetore në vitin 2015, si vijon:
1. Kursehen mjete buxhetore në shumë totale prej 29,760,888 euro, si në vijim:
 - 1.1. 23,585,034.70 euro, Tabela 1 e bashkangjitur (Kursimet në Kategorinë Ekonomike të Shpenzimeve Kapitale);
 - 1.2. 2,129,265.80 euro, Tabela 2 e bashkangjitur (Kursimet në Kategorinë Ekonomike të Subvencioneve dhe Transfereve), si dhe
 - 1.3. 4,046,587.50 euro në Ministrinë e Financave, nën-programi Kontigjenca për Paga për Pagesën e Përvojës së Punës, me kod 285, kategoria ekonomike Pagat dhe Mëditjet.
 2. Mjetet nga pika 1 e këtij vendimi ndahen në organizatat buxhetore si vijon:
 - 2.1. 25,000,000 euro në Ministrinë e Infrastrukturës, nën-programi "Ndërtimi i Autostradave" me kod 422, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, projekti "Autostrada Prishtinë-Hani i Elezit (R6)" me kod 13256;
 - 2.2. 832,200 euro në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nën-programi "Zyra për Shpronësim" me kod 605, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, projekti "Shpronësimet" me kod 13130;
 - 2.3. 2,000,000 euro në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nën-programi "Administrata Qendrore" me kod 113, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, projekti "Blerja e Librave" me kod 10144;
 - 2.4. 139,012 euro në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nën-programi Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me kod 333, kategoria ekonomike Subvencionet dhe Transferet, dhe

- 2.5. 1,789,676 euro në Komunën e Mitrovicës, kategoria ekonomike shpenzime kapitale sipas projekteve në vijim:
- 2.5.1. 514,338 euro, programi Zhvillimi Ekonomik me kod 642480, nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik me kod 480220, projekti "Ndërtimi i rrugëve në viset rurale", kodi i projektit 41328;
- 2.5.2. 63,000 euro, programi Zhvillimi Ekonomik me kod 642480, nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik me kod 480220, projekti "Ndërtimi dhe mirëmbajtja e varrezave dhe lapidarëve", me kod 90188;
- 2.5.3. 318,115 euro, programi Zhvillimi Ekonomik me kod 642480, nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik me kod 480220, projekti "Ndërtimi me kubëza betoni i rrugëve", me kod 90172;
- 2.5.4. 236,711 euro, programi Zhvillimi Ekonomik me kod 642480, nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik me kod 480220, projekti "Hartimi i projekteve për investime kapitale", me kod 90197;
- 2.5.5. 439,972 euro, programi Zhvillimi Ekonomik me kod 642480, nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik me kod 480220, projekti "Riparimi dhe rregullimi i rrugëve", me kod 41319;
- 2.5.6. 22,540 euro, programi Zhvillimi Ekonomik me kod 642480, nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik me kod 480220, projekti "Bashkëfinancim në ndërtimin e kanalizimit të ujërave të zeza", me kod 41331, dhe
- 2.5.7. 195,000 euro, programi Zhvillimi Ekonomik me kod 642480, nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik me kod 480220, projekti "Bashkëfinancim për ujësjellës me LUXDEV", me kod 90180.

II. Obligohet Ministria e Financave dhe të gjitha Institucionet e ndikuara për zbatimin e këtij Vendimi.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/67


Datë: 30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Drejtësisë për lidhjen e Marrëveshjes për Ekstradim, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Drejtësisë që të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, dhe dispozitave tjera përkatëse në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/67

Datë:30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Drejtësisë për lidhjen e Marrëveshjes për Ndihmë të Ndërsjellë në Çështjet Penale, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Drejtësisë që të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, dhe dispozitave tjera përkatëse në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/67

Datë: 30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Drejtësisë për lidhjen e Marrëveshjes për Ekzekutim të Vendimeve Gjyqësore në Çështjet Penale, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Drejtësisë që të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, dhe dispozitave tjera përkatëse në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/67

Datë: 30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohen shpronësimet shtesë të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat janë të nevojshme për realizimin e projektit me interes publik-ndërtimi i Autostradës R6 Prishtinë-Hani i Elezit, Sektori C1 dhe C2 Zonat Kadastrale: Miradi e Epërme, Komuna Fushë Kosovë, Preoc, Suhudoll, Dobtratin, Komuna Graçanicë, Konjuh, Banullë, Babush i Muhaxherëve, Gadime e Ulët, Lipjan, Marec, Smallushë, Komuna Lipjan dhe Rahovicë, Komuna Ferizaj, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat e bashkëngjitura këtij vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr.Protokolli 5462/15 datë 28.10.2015, të bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyrat kadastrale janë të obliguara të kryejnë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/67

Datë: 30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i ndërtesave të përhershme të menaxhimit të integruar të kufirit IBM, mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë: Pikat Kufitare Kapi, Zona Kadastrale Sfirçë, Komuna Kamenicë, sipas tabelës së bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Vlerësimi i pronave do të kryhet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në Ministrinë e Financave, duke u bazuar në aktet nënligjore të miratuara në përputhje me paragrafin 6. të nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 11/67
Datë: 30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Pronën Publike.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe Institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/67

Datë: 30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

Mbi Koordinimin e Reformave e të Bërit Biznes

1. Qeveria e Republikës së Kosovës do të ndërmarrë një sërë reformash me qëllim të përmirësimit të mjedisit afarist në Kosovë, i cili e favorizon zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe që bazohet në parimet e tregut të lirë dhe për përmirësimin e pozitës së Kosovës në Raportin e të Bërit Biznes të Bankës Botërore.
2. Duke e marrë parasysh faktin se të gjitha përpjekjet për përmirësimin e mjedisit afarist kërkojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe koordinim ndër-sektorial për arritjen e rezultateve të qëndrueshme dhe domethënëse, Qeveria e Republikës së Kosovës cakton organet qeveritare më poshtë si organet kryesore përgjegjëse dhe pika të kontaktit për secilin prej 10 indikatorëve të Raportit të Bankës Botërore për të Bërit Biznes:
 - 2.1. Indikatori 1: Fillimi i një Biznesi - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
 - 2.2. Indikatori 2: Dhënia e Lejeve të Ndërtimit - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
 - 2.3. Indikatori 3: Sigurimi i Energjisë Elektrike - Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
 - 2.4. Indikatori 4: Regjistrimi i Pronës - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Agjencia Kadastrale e Kosovës);
 - 2.5. Indikatori 5: Marrja e Kredive - Ministria e Financave;
 - 2.6. Indikatori 6: Mbrojtja e Investitorëve të Vegjël - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
 - 2.7. Indikatori 7: Pagimi i Tatimit - Ministria e Financave (Administrata Tatimore e Kosovës);
 - 2.8. Indikatori 8: Tregtia Përtej Kufijve - Ministria e Financave (Dogana);
 - 2.9. Indikatori 9: Zbatimi i Kontratave - Ministria e Drejtësisë;
 - 2.10. Indikatori 10: Përfundimi i një Biznesi - Ministria e Drejtësisë.

3. Secila nga Ministritë e radhitura në pikën dy më lartë do të themelojnë grupe punuese të cilat do të mbikëqyren nga Ministri përkatës, si dhe do të përfshijnë akterë të fushës së caktuar, në mënyrë që të përgatisin rekomandime konkrete për përmirësim të mëtutjeshëm, në pajtim me Metodologjinë e Bankës Botërore të Raportit për të Bërit Biznes.
4. Rekomandimet konkrete, të hartuara nën mbikëqyrjen e secilës Ministri përgjegjëse, duhet të paraqiten në formë të memorandumeve shpjeguese, të cilat përcaktojnë ndërhyrjet e nevojshme legislative, rregullative apo operacionale, që duhet të ndërmerret për përmirësimin e mjedisit afarist dhe rangimit të Kosovës në indikatorin përkatës të Raportit të Bankës Botërore për të Bërit Biznes. Secila ndërhyrje e propozuar në memorandumun shpjegues për indikatorin përkatës duhet të ketë edhe afatin e përafërt të realizimit.
5. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë caktohet si koordinatorë kryesore e këtij procesi, dhe do të themelojë një Task Forcë për të Bërit Biznes që mbikëqyret nga Ministri. Task Forca do t'i koordinoj aktivitetet me ministritë tjera të përcaktuara në pikën 2. të këtij vendimi dhe do të ofroj mbështetje metodologjike sipas nevojës.
6. Pas miratimit të këtij vendimi, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do t'i dërgoj Ministrave të Ministrive përgjegjëse një vlerësim preliminar mbi ndryshimet të cilat mund të ndërmerren në secilin prej 10 indikatorëve, së bashku me të gjitha materialet e nevojshme, për të lehtësuar punën e ministrive përgjegjëse në përgatitjen e memorandumeve shpjeguese për secilin indikator.
7. Secila Ministri përgjegjëse do të përfundojë analizën dhe memorandumet shpjeguese për indikatorët që i janë caktuar asaj, pas miratimit të këtij vendimi. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të përgatisë një përmbledhje të memorandumeve shpjeguese. Përmbledhja do të prezantohet para Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë me mbështetjen e Ministrave përgjegjës.
8. Afatet për fazat e ndryshme të këtij procesi përcaktohen nga Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si koordinatorë e këtij procesi, në bashkëpunim me Ministritë përgjegjëse për secilin indikator.
9. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/67

Datë: 30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për lidhjen e Marrëveshjes për Promovimin dhe Mbrojtjen e Investimeve, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kanadasë.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, dhe dispozitave tjera përkatëse në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/67
Datë:30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia e Kosovës për Teknologji Informative.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Institucionet tjera kompetente për zbatimin Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/67

Datë: 30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të Nenit 92 (4) dhe Nenit 93 (4), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Nenit 16 (2) të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 72/25 qershor 2010), Nenit 14 të Rregullores nr. 06/2012 për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në Nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe Nenin 19 (6.2) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Fitim Sadiku, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Administratës Publike, ricaktohet në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme.
2. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/67

Datë: 30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 Dhjetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet me vërejtje Rregullorja për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës çlirimtare të Kosovës.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për përfshirjen e vërejtjeve në tekstin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë